



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 42

Prishtinë, më 5.11.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Driton Çausi, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Arbërie Nagavci dhe Mufera Shinik.

Munguan: Albulena Balaj-Halimaj, Nezir Çoçaj dhe Verica Çeraniq.

I ftuar: **Kujtim Gashi**, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të KDI dhe mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12, 15 dhe 17.10. 2018;**
- 3. Raportim i ministrit të MKRS;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12, 15 dhe 17.10. 2018

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12, 15 dhe 17.10. 2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të MKRS

Ismajl Kurteshi, fjalën ia dha ministrit të MKRS-së, për të prezantuar para komisionit punën dhe rezultatet për periudhën raportuese janar- tetor 2018.

Kujtim Gashi, ministër i MKRS-së, gjatë prezantimit të tij, vuri në pah mekanizmat institucionalë e ligjorë, në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, duke krijuar mjedis mbështetës institucional për zhvillimin bashkëkohor të këtyre fushave, duke e promovuar identitetin kulturor, sportiv dhe rininë e Kosovës, brenda dhe jashtë vendit.

Në fushën e kulturës, ministri tha se janë realizuar plane prioritare, premiera dhe repriza të shfaqjeve të Teatrit Kombëtar të Kosovës, Baletit Kombëtar, mbajtja e koncerteve artistike të Filarmonisë, rritja e buxhetit për Qendrën Kinematografike të Kosovës për mbështetjen e projekteve filmike.

Ministri ceku hartimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me të cilën është zbatuar Ligji për sponsorizime, përfaqësimin e Kosovës në ngjarje ndërkombëtare, si në edicionin e 16-të të Bienales së Arkitekturës në Venedik 2018, në Festivalin e Filmit në Kanë, në tregun e filmit “European Film Market”, në festivalin prestigjioz “Berlinale”, në tregun e filmit “Japan Content Showcase - TIFFCOM 2017”, aleat i festivalit të madh “Tokyo International Film Festival”, si dhe pjesëmarrja e Kosovës në panaiet ndërkombëtare të librit në Paris, Frankfurt.

Një e arritur e veçantë, ministri përmendi miratimin e Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian për qasje në kuadër të programit evropian, Evropa Kreative.

Gjatë prezantimit, ai foli edhe lidhur me rezultatet dhe të arriturat në fushën e trashëgimisë kulturore, siç është themelimi i Inspektoratit për Trashëgiminë Kulturore, si organ inspektues për parandalimin e dëmtimit të trashëgimisë kulturore, si dhe miratimi i listës për trashëgimi kulturore, nën mbrojtje të përkohshme.

Në fushën e rinisë, ministria ka vazhduar me avancimin e kornizës ligjore, është në përfundim e sipër Strategjia për Rininë 2018-2023, si dhe Ligji për Rininë. Në kuadër të mbështetjes së organizatave rinore, janë mbështetur 134 projekte të organizatave rinore, në tematikën e edukimit shëndetësor, sigurisë njerëzore, kulturës, sportit dhe rekreacionit, fuqizimit të organizatave rinore dhe edukimit joformal, ku janë punësuar 200 të rinj për praktikë në punë nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës. E arritur e veçantë në fushën e rinisë, është krijimi i Fondit për Rini, sikurse dhe mbështetja financiare për ndërtimin e Qendrës së Edukimit joformal për rini, me

lokacion në fshatin Pjetërshan në Komunën e Gjakovës, si dhe ndërtimi i objekteve të qendrave rinore në Pejë dhe në Vushtrri.

Në fushën e sportit, është miratuar Rregullorja për kategorizimin e sportistëve dhe të trajnerëve, Rregullores për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative, si dhe është duke u punuar në ligjin e ri dhe Strategjinë e Sportit. Gjithashtu, e arritur e veçantë është edhe themelimi i Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative.

Teuta Haxhiu, shtroi çështjen e rregullores së miratuar, Rregullores për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe formës për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Po ashtu, kërkoi sqarim se me miratimin e kësaj rregulloreje, a do të gjejë zbatim në praktikë Ligji për sponsorizimet. Më tej, shtroi çështjen e punës vullnetare të të rinjve dhe njohjen e përvojës së punës, kur dihet se përvoja prej tre vjet kërkohet nga shumë institucione. Më tej kërkoi sqarim lidhur me projektin e dëshmorëve Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala. A ka ndërmarrë ministria ndonjë iniciativë lidhur me këtë?

Valentina Bunjaku- Rexhepi, përgëzoi ministrin lidhur me raportin e dërguar komisionit, paraprakisht, si dhe për hapat e ndërmarrë në punën e deritashme.

Fidan Rekalju, kërkoi sqarime lidhur me atë se në çfarë faze është Strategjia për Rini, duke pasur parasysh se e njëjta është premtuar të hartohet para një viti, gjithashtu edhe Ligji për Rini. Ndërsa, sa i përket punësimit të 200 të rinjve, kërkoi sqarime nga ministri se në bazë të çfarë kriteresh është bërë përzgjedhja e tyre.

Arbërie Nagavci, shtroi çështjen e institucioneve në vartësi të ministrisë, siç janë kushtet e punës së Filarmonisë së Kosovës, çështjen e stafit të Baletit të Kosovës dhe mbylljen e llogarisë për këtë kategori, si dhe çështjen e drejtorit të Teatrit dhe vendimet e Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës për shkarkimin e drejtorit dhe anulimin e disa shfaqjeve të rëndësishme me vendim të Këshillit.

Driton Çausi, foli lidhur me investimet në infrastrukturën sportive në Komunën e Gjakovës, në veçanti për stadiumin e qytetit të Gjakovës.

Ismajl Kurteshi, foli për problemet me të cilat ballafaqohen teatrot e qyteteve.

Kërkoi sqarime lidhur me realizimin e projekteve konkrete, sipas Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për qasje në kuadër të programit evropian-Evropa Kreative. Lidhur me Fondin për Rini, kërkoi sqarim sesi po realizohet ky fond dhe a është planifikuar për kualifikim të të rinjve, si dhe lidhur me shfrytëzimin e objekteve të ish-shtëpive të kulturës.

Kujtim Gashi, ministër, u përgjigj në pyetjet e shtruara nga deputetët, duke dhënë sqarimet e nevojshme, lidhur me Ligjin për sponsorizimet dhe tha se i njëjti është duke u implementuar, por me këtë rast, përmendi Ligjin për korporatat, i cili duhet të ndryshohet, me qëllim të harmonizimit me Ligjin për sponsorizimet. Sa i përket punës vullnetare, ministri tha se duhet të

hartohet Ligji për rininë dhe në të, të parashihet edhe puna vullnetare. Me këtë rast, përmendi databazën, e cila është e krijuar ku janë të regjistruar 3000 të rinj, që kërkojnë punë vullnetare.

Sa i përket Strategjisë për Rininë 2018-2023, si dhe Ligjit për Rininë, ministri tha se janë në përfundim e sipër, ndërsa sa i përket punësimit të të rinjve, tha se ministria nuk është e involvuar në punësimin e tyre.

Sa i përket sallës së Filarmonisë së Operës dhe Baletit, parashihet fillimi i punëve në vitin 2019, ndërsa sa i përket çështjes së drejtorit të Teatrit, tha se zgjedhja dhe shkarkimi i tij është kompetencë e Këshillit Drejtues.

Ndërsa, lidhur me pyetjen rreth teatrove të qyteteve, ministri tha se janë në kompetencë të komunave dhe kjo çështje duhet të zgjidhet me ligjin e ri për teatrot.

Sa i përket Fondit për Rini, ky fond ka për qëllim edhe punësimin e të rinjve, theksoi në fund ministri.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, i njoftoi anëtarët e komisionit se mbledhja e ardhshme e komisionit do të mbahet të mërkurën, me shqyrtimin e projektligjeve për plotësim-ndryshim nga fusha e sportit, që janë miratuar, në parim, në seancën e fundit.

Ai njoftoi anëtarët e komisionit se në këtë mbledhje do të diskutohet edhe lidhur me çështjen e ekskursioneve të nxënësve të Komunës së Gjilanit, që u realizuan ditë më parë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi